

## REGJISTRI I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË BASHKINË KOLONJË

*Përgatitur nga:*



## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>HYRJE</b> .....	4
<b>QËLLIMI I KËTIJ STUDIMI</b> .....	4
<b>KUADRI LIGJOR PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA</b> .....	5
<b>KUJDESI SOCIAL</b> .....	6
<b>EMERGJENCAT CIVILE - KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL</b> .....	8
<b>PROFIL I BASHKISË KOLONJË</b> .....	10
<b>INFRASTRUKTURA PAK NË BASHKINË KOLONJË</b> .....	11
Trotuaret .....	11
Vend parkimet .....	13
Stacionet e autobusit dhe autobusët .....	14
Ndërtesat publike .....	14
<b>EMERGJENCAT CIVILE NË BASHKI</b> .....	15
<b>PROFILI I PAK NË BASHKINË KOLONJË</b> .....	18
Nevojat dhe sfidat .....	20
Niveli i Përgatitjes .....	22
Qasja në informacion .....	30
<b>REKOMANDIME</b> .....	31
<b>ANEKS I - IDENTIFIKIMI DERË MË DERË</b> .....	33
<b>ANEKS II - PYETËSORI</b> .....	50

## TABELA E GRAFIKËVE

Grafiku 1: Profili i PAK në Kolonjë në raport me nivelin kombëtar .....	18
Grafiku 2: Gjinia .....	19
Grafiku 3: Grup-mosha .....	19
Grafiku 4: Edukimi .....	20
Grafiku 5: Situata e jetesës .....	20
Grafiku 6: Ndihma e nevojshme në aktivitete të përditshme .....	21
Grafiku 7: Jeta sociale e PAK / personave me lëvizje të reduktuar .....	22
Grafiku 8: Arsyet për ndjenjën e përjashtimit .....	22
Grafiku 9: Njohuritë mbi emergjencën .....	23
Grafiku 10: Njohuri mbi ligjet mbi menaxhimin e fatkeqësive në nivel kombëtar .....	23
Grafiku 11: Njohuri mbi menaxhimin kombëtar të katastrofave në nivel kombëtar .....	24
Grafiku 12: Njohuri mbi planet për menaxhimin e katastrofave në nivel lokal / komunitar .....	24

Grafiku 13: Plani personal i gatishmërisë / komunitetit për katastrofën .....	24
Grafiku 14: Arsyer e mos pasjes së një plani personal .....	25
Grafiku 15: Siguria nga plani personal i gatishmërisë.....	25
Grafiku 16: Përvoja e një fatkeqësie ose emergjence .....	26
Grafiku 17: Lloji I fatkeqësisë së ndeshur .....	26
Grafiku 18: Niveli I njohurisë ndaj fatkeqësive natyrore .....	27
Grafiku 19: Niveli i përgatitjes .....	27
Grafiku 20: Paketa/rezerva sigurie .....	28
Grafiku 21: Evakuimi në rast emergjence .....	28
Grafiku 22: Nëse jo, a keni dikë atje për t'ju ndihmuar? .....	29
Grafiku 23: Nëse po, kush mund të ndihmojë? .....	29
Grafiku 24: Mbështetje gjatë fatkeqësive / situatave emergjente .....	29
Grafiku 25: Lloji i ndihmës / asistencës së ofruar.....	30
Grafiku 26: Qasja në informacion gjatë emergjencave/ fatkeqësive natyrore .....	30
Grafiku 27: Burimi më i përshtatshëm për të siguruar informacion gjatë emergjencave/ fatkeqësive natyrore.....	31

## TABELA E FIGURAVE

Fig 1: Trotuaret, Bashka Kolonjë.....	12
Fig 2: Sipas rregullores teknike, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1503, datë 19.11.2008.....	12
Fig 3: Hapësirat për parkim, Bashkia Kolonjë.....	13
Fig 4: Sipas rregullores teknike, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1503, datë 19.11.2008. ....	14
Fig 5: Organigrama e Bashkisë.....	17

## HYRJE

Ka dy dokumente të rëndësishëm ligjor që përcaktojnë se cilët janë personat me aftësi të kufizuar. Dokumenti i parë është Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar. Kjo Konventë është ratifikuar nga shteti shqiptar në 11 shkurt të vitit 2013 dhe thekson se aftësia e kufizuar është një koncept në evolucion dhe përkufizimi i dhënë nuk duhet marrë si i ngurtë dhe i pandryshueshëm.

"Personat me aftësi të kufizuar përfshijnë ata që kanë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afat-gjata të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabartë me të tjerët."

### **(Neni 1 i Konventës)**

Po në frymën dhe gjuhën e Konventës është edhe përkufizimi i dhënë nga Ligji Nr. 93/2014 "Për Përfshirjen Sociale dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara":

*"Individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët".*

Aftësia e kufizuar është një ndërveprim ndërmjet dëmtimit të vetë personit dhe mjedisit/shoqërisë që e rrethon. Kur flasim për persona me aftësi të kufizuar kemi parasysh personat me aftësi të kufizuar në lëvizje, në shikim, në dëgjim dhe të folur dhe aftësinë e kufizuar intelektuale.

Përshtatshmëria është një term i përgjithshëm që përdoret për të përshkruar shkallën, bazuar në të cilën një produkt (pajisje, shërbim apo mjedis) është i arritshëm nga një numër sa më i madh personash. Përshtatshmëria është një koncept i lidhur ngushtë me projektimin universal.

Projektimi universal është një filozofi projektimi dhe ndërtimi, i cili duhet të shërbejë si udhërrëfyes për të gjithë arkitektët dhe ndërtuesit, në mënyrë që produktet të jenë të përshtatura për të gjithë njerëzit, pavarësisht nëse kanë ose jo aftësi të kufizuara.

Censusi i fundit i mbajtur në Shqipëri në vitin 2011 identifikoi për herë të parë që 6.2% e popullsisë mbi 15 vjeç, ose një total prej 137,435 personash, kanë ndonjë formë aftësie të kufizuar (shikimi, dëgjimi, lëvizshmëria, njohje, vet-kujdesi dhe komunikimi). Megjithatë, organizatat për aftësinë e kufizuar vlerësojnë se shumica e personave me aftësi të kufizuar mund të jetë më e lartë, duke patur parasysh se shumë individë hezitojnë të vet-identifikohen si persona me aftësi të kufizuara. Ekziston gjithashtu një keqkuptim rreth cilit grup i përkasin, sipas përkufizimit të aftësisë së kufizuar. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, rreth 15% e popullsisë botërore ka ndonjë formë aftësie të kufizuar.

## QËLLIMI I KËTIJ STUDIMI

Si pjesë e aktiviteteve të tij në kuadër të projektit 4PLUS, Instituti i Kërkimeve Urbane (URI) ka zhvilluar **ushtrimin e identifikimit "derë më derë" të personave PAK në Bashkinë Kolonjë**, në bashkëpunim shumë të ngushtë me stafin e shërbimeve sociale në Bashki. Ndër të tjera, si pjesë e këtij studimi është vlerësuar përmes **inspektimeve në terren aksesueshmëria e PAK në infrastrukturën publike të Bashkisë Kolonjë**.

Për më tepër, **intervista gjysmë të strukturuar janë zhvilluar në një grup pilot prej 60 personash**, në listën e personave të identifikuar, për të vlerësuar nivelin e ndërgjegjësimit midis PAK për nevojat, rreziqet aktuale dhe llojet e përgjashtimit me të cilat përballen PAK në periudha të rreziqeve natyrore dhe emergjencave civile.

Ndër të tjera, studimi analizon në mënyrë të përmbledhur kuadrin ligjor në lidhje me kujdesin social dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

## KUADRI LIGJOR PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Kuadri ligjor shqiptar ka parashikuar të drejtën për përshtatshmëri për personat me aftësi të kufizuara me anë të disa ligjeve. Shteti shqiptar ka ratifikuar në 11 shkurt 2013 Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, duke e pranuar këtë dokument ligjor ndërkombëtar si të detyrueshëm në kuadrin ligjor të brendshëm. Konventa e trajton përshtatshmërinë si parim të përgjithshëm dhe si të drejtë më vete në nenin 9 të saj. Ajo gjithashtu kërkon realizimin e përshtatshmërisë në nenet ku flitet për të drejtën për arsim, punësim, jetesë të pavarur etj. Përshtatshmëria është parakusht për gëzimin e të gjitha të drejtave të tjera nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Pjesëmarrja e plotë dhe efektive në shoqëri është e mundur vetëm nëse kemi mjedis, transport dhe mjete komunikimi të përshtatura.

**Neni 9 i Konventës parashikon se shtetet palë kanë detyrimin të marrin masa për eliminimin e pengesave dhe barrierave:**

- (a) Në ndërtesa, rrugë, transport, në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, qendrat shëndetësore apo ambientet e punës;
- (b) Informacion, komunikim dhe shërbime të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe ato të urgjencës.

Gjithashtu, shtetet palë duhet të marrin masat e duhura për:

- (a) Të zhvilluar, shpallur dhe monitoruar zbatimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale në lidhje me aksesin ndaj objekteve dhe shërbimeve të hapura apo të siguruar për publikun;
- (b) Të siguruar që subjektet private që ofrojnë mjete dhe shërbime, të cilat janë të hapura apo të siguruar për publikun, të marrin parasysh të gjitha aspektet e aksesueshmërisë dhe shfrytëzimit nga personat me aftësi të kufizuara;
- (c) Të ofruar trajnim për aktorët e interesit lidhur me problemet që kanë të bëjnë me aksesin për personat me aftësi të kufizuara;
- (d) Të siguruar që ndërtesat dhe objektet e tjera publike të përmbajnë shenja në gjuhën Braille dhe në forma lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme.

Një tjetër dokument ligjor i rëndësishëm është Ligji Nr. 93/2014 "Për Përfshirjen Sociale dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara". Një ndër qëllimet e këtij ligji është:

***"Të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, barrierat për personat me aftësi të kufizuara me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri."***

Neni 11 i këtij ligji parashikon se ndërhyrjet për eliminimin e barrierave financohen përmes buxhetit të shtetit: ***"Institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore, marrin gradualisht masat për sigurimin e fondeve të nevojshme për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore në ofrimin e shërbimeve publike garanton që të gjithë personat me aftësi të kufizuara janë të barabartë përpara ligjit"***. Si rrjedhojë, janë pikërisht institucionet qendrore dhe vendore të cilat do të marrin masat gradualisht për ofrimin e përshtatshmërisë. Ato kanë detyrimin për të ofruar shërbime dhe informacion të përshtatur. Po ky ligj thekson se aksesueshmëria dhe transporti i përshtatur janë elementë kyç në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi për jetesë të pavarur.

Një tjetër ligj i rëndësishëm që merret ndër të tjera edhe me përshtatshmërinë është Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Nr. 10221, datë 4.2.2010. Objekti i këtij ligji është të rregullojë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me racën, gjininë dhe aftësinë e kufizuar. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi e bën të detyrueshëm ofrimin e shërbimeve dhe të mirave të përshtatura për personat me aftësi të kufizuar, si nga subjektet publike ashtu edhe nga subjektet private. Sipas këtij ligji, një dyqan i vogël lagjeje por edhe një spital i madh privat duhet të ofrojnë elementët e përshtatshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, në të kundërt përbën diskriminim. Ky ligj parashikon si një formë diskriminimi mohimin e përshtatjes së arsyeshme, koncept ky që lidhet veçanërisht me personat me aftësi të kufizuar. Përshtatja e arsyeshme ka të bëjë me ato modifikime ose përshtatje të cilat bëjnë të mundur që një person me aftësi të kufizuar të kryejë një punë apo të marrë një shërbim në kushte të barabarta me të tjerët.

I vetmi kufizim në ligj është që përshtatja e arsyeshme të mos përbëjë një barrë të tepruar për subjektin që ka detyrimin për ta realizuar atë. Për herë të parë hartohet dhe miratohet me anë të VKM-së Nr. 1503, dt. 19.11.2008 rregullorja "Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike". Kjo është një rregullore e cila përmban të gjitha detajimet teknike për realizimin e elementëve të përshtatshmërisë në standardet e duhura.

Sipas dispozitave të rregullores "Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike" parashikohet:

#### *Neni 6: Hapësirat për këmbësorët*

Projektet e hapësirave publike dhe urbanizimi duhet të parashikojnë një rrugë hyrëse për përdorimin e impianteve ngritëse për nga shërbime sociale dhe shrytëzimin e ambienteve.

#### *Neni 9: Shkallët dhe platformat*

Shkallët duhet të sigurojnë ecje të rregullt dhe të njëtrajtshme për gjatë gjithë gjatësisë së tyre. Shkallët & rampat, platformat duhet të kenë një gjerësi min. 120 cm në hapësirat e jashtme dhe 110 cm në hapësirat e brendshme, me një pjerrësi të kufizuar dhe konstante. Rampa duhet të ketë pjerrtësi deri 1:20 (5%), dorëza mbajtëse me lartësi 10cm dhe sipërfaqe kundër rrëshqitës.

#### *Neni 19: Sinjalistika*

Sinjalistika në ndërtesa dhe hapësirat e arritshme të vendosen në mënyrë të dukshme me udhëzime për orientimin dhe shfrytëzimin e hapësirave të ndërtuara.

#### *Neni 26: Vendparkimet*

Në parkimet dhe garazhet publike, si dhe pranë objekteve ndërtimore 5% e vendeve përshtaten në raport me numrin total të vend parkimeve, por jo më pak se një.

Megjithëse kuadri ligjor duket i plotë për të garantuar përshtatshmërinë në qytetet tona, në transport e informacion, zbatimi i tij mbetet problematik.

## **KUJDESI SOCIAL**

Bazuar në të dhënat e deklaruara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, numri i përfituesve që kanë përdorur sistemin e mbrojtjes sociale për shkak të aftësisë së kufizuar është 157,434 në vitin 2015. Invalidët e punës përfaqësojnë nëngrupin më të madh (74,373 persona). Familjet me anëtarë me aftësi të kufizuara janë të varur nga **pagesat e aftësisë së kufizuar**: 79% e tyre marrin një formë transferte të mbrojtjes sociale, pothuajse sa dyfishi i familjeve që nuk kanë ndonjë

anëtar me aftësi të kufizuara. Transferta e mbrojtjes sociale përfshijnë: pagesën e paaftësisë, ndihmën ekonomike si dhe lehtësimet në pagesat e energjisë. Përveç kësaj, janë edhe 8,254 familje që marrin ndihmë ekonomike dhe që kanë një anëtar me aftësi të kufizuara, por kjo nuk ka qenë arsyeja bazë për dhënien e kësaj ndihme. Edhe pse pagesat e aftësisë së kufizuar janë rritur nga viti në vit, është ende e qartë se njerëzit me aftësi të kufizuara e kanë të vështirë të mbulojnë shpenzimet e tyre.

Përfitime shtesë janë përcaktuar për grupe të veçanta personash me aftësi të kufizuara nëpërmjet legjislacionit të specializuar (shpesh referuar si ligje-stature), të cilat parashikojnë:

- Pagesë për Aftësinë e Kufizuar (nga 10,030 lekë deri në 11,390 lekë në muaj, si dhe shuma të ngjashme për kujdestarët e tyre).
- Kompensim financiar për disa fatura mujore të shërbimeve utilitare.
- Ndihmë financiare shtesë për personat me aftësi të kufizuara që ndjekin studimet (vetëm të verbrit, paraplegjikët, tetraplegjikët, personat me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike).
- Akses me përparësi në programet e strehimit dhe nxitjes së punësimit.
- Rimbursimi i barnave dhe sigurimi shëndetësor falas.
- Ndihmë financiare të veçantë për personat me aftësi të kufizuara të cilët humbën vendin e tyre të punës pas vitit 1991 (vetëm të verbrit).
- Karrige me rrota, paterica, paketa higjieniko-sanitare falas (vetëm për paraplegjikët dhe tetraplegjikët), edhe pse karriget me rrota apo mjetet e tjera ndihmëse deri tani janë ofruar në disa raste nga donatorë të ndryshëm.
- Përrjashtimin nga taksat direkte.
- Përrjashtime tatimore dhe doganore për pajisje rehabilitimi dhe automjetet (vetëm për paraplegjikët, tetraplegjikët dhe invalidët e punës); rimbursim të karburantit në vlerën 7000 lekë/muaj (vetëm invalidët e punës).

Personat me aftësi të kufizuara si pasojë e një aksidenti në punë, sëmundjeve profesionale dhe personat me pension të plotë invaliditeti nga një sëmundje gjenetike gjithashtu përfitojnë ndihmë financiare shtesë, në varësi të shkallës së aftësisë së kufizuar.

Çdo ndihmë financiare e lartpërmendur jepet edhe 24 muaj të tjerë pasi përfituesi gjen punë, Përrfitimet e marra nga personat me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike gjithashtu nuk përrfshihen në llogaritjen e të ardhurave të familjes kur bëhet vlerësimi i të drejtës për të përfituar nga skema e ndihmës ekonomike. Megjithatë, personat që marrin një pagesë për aftësinë e kufizuar nuk përrfshihen në numrin e anëtarëve të familjes për llogaritjen e përrfitimeve nga ndihma ekonomike.

Personat me aftësi të kufizuara kur kualifikohen si të tillë nga vlerësimi i kryer nga KMCAP përfitojnë pagesë për aftësinë e kufizuar. Kjo pagesë nuk bazohet në vlerësimin e nevojave të personit me aftësi të kufizuara dhe nuk cilëson çfarë supozohet të mbulojë. Kur shikojmë tendencat e mbulimit, mund të vihet re se numri i personave me aftësi të kufizuara që marrin pagesa është rritur me 28% nga viti 2009 deri në vitin 2013, ndërsa buxheti i shtetit në total është rritur 62% për të njëjtën periudhë.

## EMERGJENCAT CIVILE - KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Kuadri ligjor dhe ai institucional për përballimin e emergjencave civile parashikon ndërtimin e një rrjeti kombëtar të institucioneve dhe rolet përkatëse të tyre në rast të një emergjence civile. Pjesa e madhe e këtij legjislacioni është hartuar para miratimit të ndarjes së re territoriale dhe më e rëndësishmja para kalimit të mbrojtjes civile si funksion i bashkive, që ndodhi me miratimin e Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Referuar nenit 29 të këtij ligji, bashkitë janë përgjegjëse për garantimin e këtyre funksioneve në fushën e sigurisë publike:

1. Mbrojtjen civile, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
2. Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
3. Garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet.
4. Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të njësisë të vetëqeverisjes vendore brenda juridiksionit të tyre vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore.

Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, miratuar më 29.07.2015 parashikon nevojën për ndërhyrje dhe harmonizimin e legjislacionit përkatës në fushën e qeverisjes vendore për t’ju përshtatur rrethanave dhe kushteve të reja në qeverisjen vendore. Strategjia ka parashikuar tre fusha kryesore:

### ***Mbrojtja kundra zjarrit***

Bashkive ju ka kaluar si funksion i vetë funksioni i shërbimit të mbrojtjes kundër zjarrit në nivelin vendor, siç shpjegohet më poshtë.

### ***Mbrojtja civile***

Strategjia dhe ligji i ri për mbrojtjen civile të rishikojnë dhe përmirësojnë kompetencat dhe rolin e autoriteteve vendore në fushën e mbrojtjes civile me qëllim rritjen e efikasitetit të strukturave në mbrojtje të jetës dhe pronës së qytetarëve.

**Ligji i ri “Për mbrojtjen Civile”** ngarkon me përgjegjësi institucionet dhe strukturat e mbrojtjes civile, në nivel vendor, si më poshtë:

- i. prefekti i qarkut;
- ii. komisioni i mbrojtjes civile në nivel qarku dhe bashkie;
- iii. bashkitë;
- iv. strukturat e decentralizuara të institucioneve dhe të strukturave qendrore të mbrojtjes civile.

### **Sipas këtij ligji, bashkitë ngarkohen me këto detyra:**

- a. brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, kryejnë vlerësimin e risqeve në territorin e tyre, duke hartuar dhe miratuar dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë, të cilin ia dërgojnë prefektit të qarkut dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për qëllime analizimi dhe planifikimi;
- b. informojnë publikun dhe komunitetin e rrezikuar, bazuar në dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë;
- c. hartojnë dhe rishikojnë strategjinë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë;



- d. hartojnë, miratojnë dhe përditësojnë planin vendor për emergjencat civile dhe ia dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe prefektit të qarkut, për qëllime analizimi dhe planifikimi.
- e. organizojnë veprimtari trajnuese në fushën e mbrojtjes civile për punonjësit dhe banorët në territorin e tyre;
- f. sigurojnë funksionimin e sistemit të monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në territorin e tyre dhe informojnë në kohë komunitetin e rrezikuar, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe prefektin e qarkut për fatkeqësitë në territorin e qarkut;
- g. sigurojnë, administrojnë dhe përditësojnë të dhënat e nevojshme për shtetasit dhe për subjektet private, të mundshme për t'u planifikuar dhe angazhuar në parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive;
- h. brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, krijojnë bazën e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë për territorin e bashkisë, të cilën e mirëmbajnë dhe e përditësojnë, si edhe shkëmbejnë informacione me prefektin e qarkut dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;
- i. kryejnë investime parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese nga fatkeqësitë dhe informojnë për këto investime në mënyrë të vazhdueshme prefektin e qarkut, si dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.
- j. caktojnë drejtuesin e operacionit në nivel bashkie për përballimin e fatkeqësisë në territorin e saj;
- k. kryejnë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë në territorin e tyre, vlerësimin e nevojave për përballimin e tyre, si dhe dëmshpërblejnë shtetasit për fatkeqësitë e ndodhura në territorin e tyre;
- l. bashkëpunojnë me bashkitë fqinje në zbatim të detyrave që lidhen me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, me qëllim bashkimin e kapaciteteve të tyre për trajtimin e çështjeve të përbashkëta në këtë fushë.
- m. mbajnë në gatishmëri sistemet e mbrojtjes nga zjarri, kalueshmërinë e pandërprerë të rrugëve rurale, vendet e strehimit, si dhe mbledhin dhe administrojnë rezervat ushqimore për njerëzit dhe gjënë e gjallë.
- n. aktivizojnë kapacitetet e subjekteve publike e private brenda territorit administrativ të tyre, bashkëpunojnë dhe asistojnë bashkitë fqinje dhe marrin çdo masë tjetër të nevojshme për përballimin dhe lehtësimin e fatkeqësive.
- o. mbajnë në gatishmëri infrastrukturën e ujitjes, të kullimit, të mbrojtjes nga përmytja dhe digat e rezervuarëve në administrim të tyre.

## PROFIL I BASHKISË KOLONJË

Bashkia e Kolonjës kufizohet në veri me bashkitë e Devollit dhe të Korçës, në perëndim dhe jug me bashkinë e Përmetit, ndërsa në lindje me Greqinë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Ersekës. Kjo bashki përbëhet nga 8 njësi administrative, të cilat janë: Ersekë, Qendër Ersekë, Leskovik, Qendër Leskovik, Novoselë, Barmash, Mollas dhe Çlirim. Bashkia e Kolonjës ka në administrimin e saj dy qytete: Ersekë dhe Leskovik, si dhe 76 fshatra, që janë të përfshira në njësitë administrative si në vijim:

<b>Qendër Ersekë:</b> Starie, Bejkovë, Psar, Selenicë, Kreshovë, Gostivisht, Lëngës, Kodras, Kabash, Borovë, Taç Qëndër, Taç Poshtë, Taç Lartë, Rehovë, Gjong, Prodan
<b>Qendër Leskovik:</b> Pobickë, Cerckë, Radat, Radovë, Postenan, Lashovë, Peshtan, Podë, Kovaçisht, Vrepckë, Gërmenj, Radanj, Glinë, Gjirakar
<b>Novoselë:</b> Novoselë, Mesiçkë, Kagjinas, Zharkan, Piskal, Vitisht, Shijan, Kaduç, Ndërmarr, Mbreshtan
<b>Barmash:</b> Barmash, Leshnjë, Shalës, Gozhdorazhd, Sanjollas, Kamnik, Bënjëz, Radimisht, Arrëz, Rajan
<b>Mollas:</b> Mollas, Skorovot, Qinam, Vodicë, Qafzez, Helmës, Shtikë, Pepellash, Butkë, Kozel, Milec, Bezhan, Boshanj, Blush
<b>Çlirim:</b> Çlirim, Qesarak, Kaltanj, Qytezë, Selenicë e Pishës, Luaras, Lënckë, Kurtez, Orgockë, Qinam-Radovickë, Radovickë, Psar i Zi

### Popullsia

Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia numëron 11.074 banorë, ndërsa sipas Regjistrat Civil kjo bashki numëron një popullsi prej 19,919 banorësh, në një sipërfaqe prej 864.06 km<sup>2</sup>. Diferenca e madhe ndërmjet këtyre shifrave mund të shpjegohet me lëvizjen migratore, që për këtë zonë ka patur përpjesëtime mjaft të mëdha, të paflektuar ende në regjistrat e gjendjes civile. Bashkia e Kolonjës ka një densitet prej 7.5 banorë/km<sup>2</sup> (disa herë më e ulët se mesatarja në rang vendi: 97.4, për shkak të sipërfaqes së madhe me zonë malore).

Të dhënat aktuale të vitit 2015 flasin për një numër total prej 22,2 mijë banorësh dhe 6,343 familje të regjistruar në gjendjen civile, krahasuar përkatësisht me rreth 22,6 mijë banorë dhe 5005 familje në vitin 2000. Qyteti i Ersekës shtrihet gati në qendër të pllajës së Kolonjës, në këmbë të malit të Gramozit me distancë 2 km nga rrëza e tij dhe ka një sipërfaqe prej 1,1 km<sup>2</sup>; 2,266 familje dhe 6.726 banorë. Qyteti i Leskovikut, për vitin 2015, numëronte rreth 3 mijë banorë dhe 800 familje.

Duket se rënia e numrit të popullsisë, sipas regjistrave, është frenuar pas vitit 2011, madje ka patur rritje drejt niveleve të para 15 viteve. Njohja e saktë e dinamikës së ndryshimit të popullsisë kërkon verifikime të sakta në terren, në mënyrë që parashikimi për vitet në vijim të jetë një variabël bazë, i përlogaritur saktë, në funksion të planifikimit të ardhshëm strategjik. Raporti gjinor, sipas të dhënave të Censurit të vitit 2011 rezulton të jetë 104.2, pak më i lartë se mesatarja kombëtare prej 100.4, gjë që mund të shpjegohet pjesërisht me fenomenin më të lartë të migrimit tek gjinia femërore, kryesisht për arsimim të mëtejshëm e punësim.

Në Bashkinë e Kolonjës, grup moshë 15 – 64 vjeç përbën 68.1 % të totalit të banorëve, duke qenë thuajse po aq sa mesatarja kombëtare (68%), ndryshe nga grup moshë e fëmijëve: 15,6% (mesatarja në rang vendi 20%), gjë që tregon për rënie të lindshmërisë në dekadat e fundit. Emigrimi i popullsisë

ka qenë i drejtuar kryesisht jashtë shtetit (afërsia me Greqinë), por edhe drejt qyteteve të tjera të Shqipërisë (Korçë, Tiranë etj.). Kthimi i emigrantëve deri në vitin 2011 ka qenë i papërfillshëm, rreth 510 persona gjithsej, (0.36% e totalit të emigrantëve të kthyer).

## INFRASTRUKTURA PAK NË BASHKINË KOLONJË

**Zbatimi i rregullores "Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike" në Bashkinë Kolonjë:**

### Trotuaret

Trotuarët janë ndoshta forma më e dukshme e mungesës së aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Në Kolonjë trotuaret prezentë në rrugët e qytetit Ersekë janë në gjerësi të duhur. Megjithatë, vërehet mungesa e rampave në pjesën më të madhe të tyre si dhe mungojnë vijëzimet orientuese, dhe sinjale me tingull. Nga ana tjetër, në njësitë administrative të bashkisë, trotuaret sipas standardeve mungojnë plotësisht.

Së fundmi Bashkia ka rikonstruktuar sheshin "Rilindja" ku ndryshe nga pjesa tjetër e qytetit vërehet prezenca e rampave sipas standardeve, duke lehtësuar kështu lëvizshmërinë e personave me aftësi të kufizuar.






Fig. 1: Trotualet, Bashka Kolonjë




Fig 2: Sipas rregullores teknike, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1503, datë 19.11.2008.



## Vend parkimet

Hapësirat e rezervuara për parkim janë pothuajse jo të pranishme në Bashkinë Kolonjë, shpesh sporadike për të sjellë një ndryshim të rëndësishëm në lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara, të cilët përdorin makinat jo si një objekt luksi por si alternativën e vetme, për shkak të mungesës së transportit publik të aksesueshëm.



*Fig 3: Hapësirat për parkim, Bashkia Kolonjë*

Përveç pamjaftueshmërisë së hapësirave të rezervuara për parkim për personat me aftësi të kufizuara, një problem tjetër është projektimi i këtyre hapësirave të parkimit jo brenda standardeve të parashikuara në vendimin për rregulloren teknike të përmendur më lartë. Sipas nenit 12 të rregullores teknike, hapësirat e rezervuara për parkim duhet të jenë 6m në gjatësi dhe kur ka hapësira të shumta paralele parkimi, duhet të ketë hapësirë shtesë mes vendit të rezervuar të parkimit dhe të tjerave. Standardi teknik shpjegohet edhe me ilustrime nga vetë rregullorja.




Fig 4: Sipas rregullores teknike, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 1503, datë 19.11.2008.

## Stacionet e autobusit dhe autobusët

Transporti publik prezent në Bashkinë Kolonjë është ai ndërqytetës dhe në përgjithësi është shumë problematik dhe jo i aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara. Në autobusë mungojnë platformat e pjerrëta, por edhe në pakë raste kur ka stafi nuk është zakonisht i prirur për t'i hapur. Brenda autobusit nuk ka tabela të itinerarit për të ndihmuar personat me dëmtime të dëgjimit dhe as sinjale zanore për të njoftuar mbërritjen në një vend të caktuar për personat me dëmtime pamore. Në ato pak raste kur ka stacione për shërbimin e transportit ndër-qytetas, nuk janë ndërtuar në mënyrë që të bëjnë aksesin për personat me aftësi të kufizuara të vështirë dhe të pasigurt.

**Kryqëzimet** në Kolonjë nuk përmbushin kriteret e nevojshme për lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara. Vështirësi hasen kur këta persona janë të shoqëruar, ndërkohë që lëvizja e pavarur është e pamundur. Lëvizja për personat e verbër është e pamundur sepse mungojnë linjat orientuese me relief. Në skaj të rrugës nuk ka rampat me material relievor dhe jo i rrëshqitshëm për kalimin e disnivelit midis trotuarit dhe rrugës. Shpesh ky disnivel është tepër i lartë (mbi 5 cm) dhe pengon kalimin e personave me vështirësi në lëvizje. Kalimi i rrugës nga persona me vështirësi në shikim bëhet më e vështirë nga mungesa e semaforëve akustik (me sinjal zanor). Ndërsa vijat e bardha nuk kanë material të ashpërsuar paralajmërues dhe ndonjëherë mungojnë plotësisht.

Kryqëzimet midis vendkalimeve të këmbësorëve duhet të kenë vija relievore dhe sinjalizues akustikë për personat me vështirësi në shikim. Vija relievore paralajmëruese realizohet deri tek skaji i pjerrtësisë së kalimit në gjatësi jo më të vogël se 110 cm. Kur në udhëkryq nuk mund të evitohen pengesat në nivel të njëjtë, realizohen nënkalime ose mbikalime me aplikimin e elementeve përshtatës për arritjen në nivele me lartësi të ndryshme sipas dispozitave të rregullores "Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike".

## Ndërtesat publike

Vështirësitë për të aksesuar ndërtesat publike, në Bashkinë Kolonjë, fillon nga shkallët që nuk përmbushin kriteret dhe përfundon me mungesën totale të rampave. Ndërtesat publike në Kolonjë janë si më poshtë:

- ✓ Bashkia Kolonjë
- ✓ Spitali "Shaniko Jaupasi"
- ✓ Poliklinika
- ✓ 23 qendra shëndetësore primare
- ✓ Zyra Arsimore

- ✓ 40 institucione arsimore shtetërore (nga këto 18 kopshte, 19 shkolla 9-vjeçare dhe 3 shkolla të mesme)
- ✓ Qendra kulturore “Fan Stilian Noli”
- ✓ Zyrat e Agjencisë së Sigurimeve Shoqërore
- ✓ Ujësjiellës – Kanalizime
- ✓ OSHEE
- ✓ Ndërmarrja e Pyjores
- ✓ Posta Shqiptare
- ✓ Njësitë Administrative

Përveç vështirësive në trotuare e kryqëzime, personat me aftësi të kufizuara kanë barriera për të aksesuar edhe ndërtesat publike. Pjesa më e madhe e ndërtesave publike në Kolonjë janë të paaksesueshme nga personat me karrige me rrota për shkak të mungesës së rampës ose pasjes së një rampe tepër të pjerrët e jo në standardet e duhura teknike. Personave me vështirësi në shikim u mungon informacioni në Braille. Gjithashtu, shkallët nuk përmbushin parametrat e duhura. Shpesh mungojnë parrmakët për mbështetje dhe sipërfaqet me relief që japin informacion në lidhje me fillimin dhe mbarimin e shkallës.

Ndërtesat publike, të cilat arrihen nëpërmjet shkallëve, duhen të jenë të pajisura edhe me rampë që mundëson aksesin nga hyrja kryesore e ndërtesës edhe për personat me aftësi të kufizuara. Konsiderohet i arritshëm kalimi i një disnivele deri në 320 cm nëpërmjet platformave të pjerrëta të vendosura njëra pas tjetrës.

Sinjalistika në ndërtesa duhet të vendoset në mënyrë të dukshme që të shihen lehtësisht tabelat me udhëzime për orientimin dhe shfrytëzimin e hapësirave të ndërtuara.

***Së fundmi Bashkia Kolonjë ka përfunduar rikonstruksionin e godinës së Bashkisë si dhe atë të “ish çerdhes” e cila do të përdoret për funksione sociale, të dyja të ndërtuar sipas standardeve të parashikuara në rregulloren teknike në lidhje me praninë e rampave dhe shkallëve sipas parametrave.***

## EMERGJENCAT CIVILE NË BASHKI

Siç vërehet në organigramën e Bashkisë mungon një drejtori apo sektor i dedikuar për emergjencat civile. **Ndërkohë, një specialist emergjencash civile është i vendosur në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.** Bazuar në rregulloren më të fundit të bashkisë, atë të vitit 2020, specialisti për emergjencat civile, është përgjegjës për sa më poshtë:

- Të marrë masa për ruajtjen e pasurisë së bashkisë apo të komunës si dhe të atyre që administrohen nga ana e saj.
- Të kujdeset për qetësinë publike, duke shmangur zënie, mënjana zhurmat e shkaktuara nga grumbullimet e njerëzve, altoparlantët e radiove e magnetofonave, që sjellin shqetësime për të tjerët.
- Të marrë masa për ruajtjen e rendit, kur ka grumbullime njerëzish, si në tregje, panairë, ceremoni publike, artistike, fetare e sportive, në kinema, teatro, pallate e salla sportive, objekte të kulturi dhe në mjedise të tjera publike.
- Të inspektojë respektimin e dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shitblerjes në mjedise publike Të kontrollojë marrjen e masave të sigurisë që parandalojnë fatkeqësitë e ndryshme natyrore si dhe të ndihmojë në kapërcimin e tyre duke marrë masat gjithashtu për dhënien e ndihmës të dëmtuarve në raste urgjence.

- Të drejtojë organizimin dhe bashkërendimin e punëve për hartimin e planeve të përgatitjes për emergjencë civile në bashki dhe për zbatimin e masave të mbrojtjes;
- Të grumbullojë dhe të përpunojë të dhënat e nevojshme nga njësitë administrative të bashkisë për zbatimin e detyrave të planëzimit dhe përballimit të emergjencave civile;
- Të realizojë organizimin, bashkërendimin dhe pajisjen e forcave operacionale; të ndjekë realizimin e detyrave për lehtësimin e efekteve të emergjencës civile dhe për organizimin e ndërhyrjes për të vepruar;
- Të ndjekë riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera;
- Të zbatojë detyrat e caktuara nga strukturat e planëzimit dhe të përballimit të emergjencave civile në nivel qendror.

Nga ana tjetër, në institucionet e varësisë ndodhet Mbrojtja nga Zjarri Dhe Shpëtimi (MZSH) me 4 staf, ngarkuar me detyrat e mëposhtme:

Marrjen e masave të inspektimit, parandalimit dhe ndërhyrjes për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin në territorin e bashkisë;

Drejtimin e shërbimit të MZSH-së për gatishmërinë e personelit, të automjeteve dhe pajisjeve zjarrfikëse;

Zbatimin e ligjshmërisë, zbatimin e masave inspektuese dhe parandaluese për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin në të gjitha objektet në territorin e bashkisë;

Bashkëpunimin, koordinimin e veprimeve të strukturave për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin me strukturat e tjera operuese dhe inspektuese që veprojnë në territorin e bashkisë;

Mbajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të shërbimit të MZSH-së si dhe përpilimin e statistikave për aktivitetin dhe veprimtarinë e shërbimit në nivel vendor, në përputhje me legjislacionin në fuqi

Kontrollin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në objektet me rëndësi ekonomike e strategjike dhe të shërbimit vullnetar;






Fig 5: Organigrama e Bashkisë

**Në faqen e Bashkisë Kolonjë, informacioni i mëposhtëm është bërë publik në rastin e emergjencave si tërmeti:**




- ✓ gjatë rënies së tërmetit në shtëpitë një katësh ne duhet të veprojmë shpejt por me kujdes.
- ✓ nëse nuk dalim nga ndërtesa, gjunjëzohu në vende të sigurta duke vepruar si në vijim “*shtrihu, mbulohu, mbahu*”.

- mbahu tek tavolina e bukës apo në tavolinë tjetër në mënyrë që pllaka e tavolinës të jetë mbi ju.
  - ule kokën poshtë dhe mbyll sytë.
  - qëndro në këtë pozicion deri sa të ndalen dridhjet.
- ✓ rri të qetë dhe gjej vend të sigurt për tu mbajtur dhe kur ka lëkundje të përsëritura të tërmetit. Pas tërmetit mos ndizni qirinj apo shkrepëse deri sa të siguroheni që nuk ka rrjedhje gazi.
  - ✓ siguroni gjërat kërcënuese për jetën si dhe gjërat që bllokojnë daljet dhe largoheni atë nga rruga.
  - ✓ vendoseni krevatet në vende që nuk gjenden drejtpërdrejt nën elementë ndriçimi, nën pasqyra të rënda, piktura, nën dollapët, rafta me shumë gjëra që mund të bien.
  - ✓ largimi i shisheve gotave prej qelqi nga dollapët e lartë.
  - ✓ bllokimi i objekteve me rrota në mënyrë që të mos lëvizin.
  - ✓ zvogëloni rrezikun nga xhamat që mund të thyhen në copa të mëdha.


- ✓ siguroni gjërat që do të sjellin humbje të konsiderueshme ekonomike (gjëra të vlefshme të trashëgimisë të familjes, gjëra që thyhen)
- ✓ largoni materialet që mund të digjen nga burimet e ndryshme të nxehtësisë, materialet e rrezikshme ti kontrolloni që të jenë në vende të sigurta.
